



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 50 Prot.

Tiranë, më 10. 01. 2018

V E N D I M

Nr. 8, Datë 10. 01. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 175 rregj., datë 21.12.2015, të K. Rr., ku pretendohet diskriminim për shkak të “racës”¹ dhe “gjendjes ekonomike”, nga ana e Njesisë Administrative Otlak, Berat.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se Bashkia Berat ka bërë të mundur kryerjen e rikonstruksionit të banesave për një pjesë të familjeve të fshatit Stan-Moravë, Berat. Ankuesi ka ngritur pretendimin se rikonstruksioni i banesës së tij është lënë pa përfunduar dhe se nuk ka asnjë informacion, nëse do të përfundojë apo jo.

“Raca” dhe “gjendja ekonomike” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore,

¹ Ankuesi i përket komunitetit rom.

përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 32 Prot., datë 11.01.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi Bashkinë e Beratit mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion të detajuar mbi çështjen e parashtruar nga ana e ankuesi, K. Rr.
 - Për sa më sipër, Bashkia Berat nuk e dërgoi informacionin e kërkuar, në përgjigje të shkresës nr. 32 Prot., datë 11.01.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Në vijim të procedurave hetimore, në zbatim të Urdhërit nr. 34, datë 07.03.2016, të Komisionerit “Për kryerjen e inspektimit pranë Bashkisë Berat, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesat e banorëve të lagjes Stan, Moravë, Berat”, me qëllim kryerjen e verifikimeve, mbi pretendimet e ankuesit, grupi i inspektimit të KMD-së, në datën 10.03.2016, kreu inspektim pranë Bashkisë Berat.

Inspektorët e KMD-së u takuan me B. B., Nënkryetar i Bashkisë Berat, i cili sqaroi se informacioni i kërkuar në Urdhërin nr. 34, datë 07.03.2016, të Komisionerit, do të vihej në dispozicion të tyre, brenda datës 18 mars 2016.

- Nëpërmjet shkresës nr. 205, datë 04.04.2016, të Njesisë Administrative Otlak, Berat, Komisioneri bëhet me dije se: *“Në lidhje me procedurat e ndjekura nga Njësia për përzgjedhjen e familjeve që kanë përfituar investime nuk kemi asnjë informacion. Me shkresën nr. 181, datë 18.03.2016, i kemi kërkuar informacion ish Kryetarit të Komunës, D. K., në lidhje me këtë procedurë, por nuk morëm informacion”.*
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua sërish Bashkisë Berat, me shkresën nr. 32/1, datë 24.05.2016, ku iu bë kujtesë, në lidhje me faktin se duhej të dërgonte informacionin dhe dokumentacionin përkatës, të kërkuar nga KMD, brenda datës 10.06.2016. Bashkia Berat u bë me dije se në rast të mosdhënies së informacionit, do të gjobitej mbështetur në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Pavarësisht sa më sipër, Bashkia Berat nuk dërgoi asnjë përgjigje në adresë të Komisionerit.

- Në këto kushte, pas kryerjes së të gjithë hapave proceduriale për shqyrtimin e ankesave² të banorëve të Njesisë Administrative Otlak, Komisioneri vlerësoi dhe gjykoi se Bashkia Berat nuk kishte ofruar bashkëpunim dhe se nuk kishte dhënë informacionin e kërkuar nga Komisioneri, mbi bazën e të cilit, do të shqyrtoheshin ankesat në fjalë. Në bazë të ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ish-Komuna Otlak e Bashkisë Berat aktualisht është emërtuar si Njësia Administrative Otlak. Por, pavarësisht ndryshimeve ligjore të emërtesës, strukturës apo të titullarëve të njesisë përkatëse, dokumentacioni i ish-Komunës Otlak duhej të administrohet pranë Njesisë Administrative Otlak. Në kushtet e mosdhënies së informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri, Bashkia Berat u gjobit nëpërmjet vendimit nr. 127, datë 09.08.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Bashkia Berat e ankimoi Vendimin nr. 127, datë 09.08.2016, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Me vendimin nr. 80-2016-5470, datë 17.11.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë u vendos pranimi i kërkesë-padisë së paraqitur nga Bashkia Berat dhe shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ – Vendimi nr. 127, datë 09.08.2016, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në pikën 4 të vendimit gjyqësor është vendosur, që në zbatim të nenit 45/a, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ky vendim të jetë i paankimueshëm.

Në këto kushte, në mungesë të informacionit të nevojshëm, Komisioneri gjykon se shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës së sipërpërmendur dhe arritja e qëllimit për të dalë në një përfundim, nëse K. Rr. si banorë i ish-komunës Otlak, Berat është diskriminuar ose jo, është bërë i pamundur.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 20-21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

² 12 banorë të lagjes Stan-Moravë kanë paraqitur ankesë lidhur me rikonstrukcionin e banesave nga Ish-Komuna Otlak.

V E N D O S I :

- 1.** Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 175, datë 21.12.2015, të K. Rr., pasi qëllimi për të cilin është nisur procedura e shqyrtimit të tij, është bërë i pamundur.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.
- 3.** Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca dhe gjendja ekonomike)
(Fusha; Të mira dhe shërbime)